



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 212 Nr. i faq/Br.str/No.pg 68

Data/Datum/Date 25.07.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

- Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 02/4397/24, i datës 04.07.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një), deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
- Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 të këtij propozimi, janë:

Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00889-0 në zonën kadastrale Çifllak, në vendin e quajtur *Seishta*, me kulturë arë e klasës IV, në sipërfaqe të përgjithshme prej 35227m<sup>2</sup> ( tridhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet e shtatë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit, të jepen në shfrytëzim në sipërfaqe prej 8.600 m<sup>2</sup> (tetëmijë e gjashtëqind metra katror).
- Qëllimi i dhënies në shfrytëzim, i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
- Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
- Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kurdo herë që, sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës, të ndryshojë kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
- Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana

e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, të zhvillojë procedurat e ankandit publik, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në faqen ueb të Komunës së Rahovecit.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01-Nr.232/24  
Me datë:25.07.2024

